REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 16/23
Datë/Datum. 22.03.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 16/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) "Invest Pro" SH.P.K & "Trasing Group" sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë - Faza e IV" me numër të prokurimit 204-22-10111-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 22.03.2023, mori:

V E N D I M

1. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e GOE "Invest Pro" SH.P.K & "Trasing Group" sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, e parashtruar në OSHP me 06.01.2023 (Protokolli 16/2023) për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë-Faza e IV" me numër të prokurimit 204-22-10111-5-1-1, ndërsa **Anulohet** Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës i datës 22.12.2022, kurse aktiviteti i prokurimit i precizuar si më sipër kthehet në **rivlerësim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi), në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP

3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse ankuesi GOE "Invest Pro" SH.P.K & "Trasing Group" sh.p.k. ka të drejtë të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën depozita konfiskohet dhe mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.12.2022, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në cilësinë e AK, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë-Faza e IV" me numër të prokurimit:204-22-10111-5-1-1, sipas të cilit është rekomanduar për kontratë OE "Pro&Co Group SH.P.K.

Me 27.12.2022, GOE "Invest Pro" sh.p.k & "Trasing Group" SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar si e pa bazuar me vendimin e AK të datës 28.12.2022.

Me 06.01.2023 GOE "Invest Pro" sh.p.k & "Trasing Group" SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP (Protokollit 16/2023) kundër Njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Bazuar në aktet dhe veprimet e përshkruara si më sipër, konstatohet paraprakisht se Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë. Vlera e parashikuar është: 726 895,80 €.Kriteri dhënies se kontratës: Tenderi i përgjegjshme me çmim me të ulet.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se Ankesa është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Meqë Ankuesi ka statusin e palës me interes sipas paragrafi 1.26, të nenit 4 të LPP dhe meqë ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara, e njëjta bie nën kompetencat e këtij Organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 lidhur me nenin 114, të LPP të bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 18.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e GOE "Invest Pro" SH.P.K & "Trasing Group" sh.p.k. të aprovohet si e bazuar.
- Të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 22.12.2022 për dhënie të kontratës;
- Aktiviteti i prokurimit të kthehet ne rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç; rast OE është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues ndërsa AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë konform nenit 24 paragrafi 2, të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde, dëgjimit të palëve, pretendimeve të tyre ankimore dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues konsideron se gjetjet e ekspertit dhe rekomandimet e tij janë të pranueshme dhe si rrjedhojë Paneli vendosi që ankesa GOE "Invest Pro" sh.p.k & "Trasing Group" sh.p.k të aprovohet si e bazuar.

Paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues vëren se AK në dosjen e tenderit (DT) dhe në njoftimin për kontratë (NJK) konkretisht, në piken 1 si kriter financiar ka paraparë: Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose qasje në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00 € duke kërkuar që OE si dëshmi të dorëzoj dokumentin origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga banka kompetente përkitazi më këtë projekt.

Lidhur me ketë, ekspertit shqyrtues ka shpjeguar se arsyetimi i AK se dokumenti i lëshuar nga banka nuk i plotëson kriteret e parapara ne DT dhe në NJK është i paqëndrueshëm, sepse është kërkuar që dokumenti të jetë origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga institucioni bankar dhe nuk janë paraparë arsyet në të AK është bazuar në eliminimin e ankuesit. Paneli shqyrtues vlerëson se nuk është i qëndrueshëm edhe arsyetimi i dhënë në refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK përderisa është e drejtë ekskluzive e AK që në rastet e tilla të kërkoj informata plotësuese meqë të njëjtat kanë karakter relevant lidhur me vendosjen meritore. Prandaj Oshp konsideron se nëse AK ka pasur dilema lidhur dokumentin në rastin konkret është dashur, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 59 paragrafi 2 dhe nenit 72 të LPP, të kërkoj informata dhe/ose nga OE, në mënyrë që krahasimi dhe vlerësimi i tenderëve të aplikohet në mënyrë profesionale dhe transparente, ashtu siç parashihet shprehimisht me dispozitat e cituara. Autoriteti kontraktues ka të drejtë ti ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat dhe duke i mbështetur gjetjet dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues në ketë rast, Paneli shqyrtues konsideron se AK gjatë këtij aktivitet të prokurimit, nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP prandaj OSHP kërkon nga AK që në procesin e rivlerësimit ti ketë ne konsideratë shpjegimet e dhëna si më sipër.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK (në cilin do nivel) të jenë të vëmendshëm gjatë rrjedhës së aktivitetit të prokurimit duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës

së Kosovës dhe rregullat e zbatueshme dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, mirëpo pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- GOE "Invest Pro" SH.P.K & "Trasing Group" sh.p.k. në Fushë Kosovë
- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe;